

**Ditari i fëmijëve**

**Piketat zhvillimore për fëmijët 0-3 vjeç**

Shënoni me ✓ në katrorat pranë tekstit më poshtë për të identifikuar piketat e zhvillimit të fëmijës tuaj.

**Si Fëmijët e Tjerë 2 Muajsh, Unë Kam Filluar Të:**

- Buzëqeshë njerëzve spontanisht
- Qetësoj veten për pak kohë (të ofrojë dorën tek goja ose të thithë gishtin tim)
- Mendohej të shikojë prindërit
- Bëjë zëra gurguluese
- Kthej kokën në drejtim të zërit
- Kushtoj vëmendje fytyrave
- Percjelli gjërat me sy dhe të dalloj njerëzit e tjerë në distancë
- Shprehi mërzinë (qaj) nëse aktiviteti nuk ndryshon
- Mbaje kokën lartë dhe të qohem lartë kur jam i/e shtrirë në bark
- Bëj lëvizje të lehta me këmbë dhe duar

**Nënë dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Nuk i përgjigjem tingujve me zë të lartë
- Nuk i përcjell gjërat kur lëvizin
- Nuk buzëqeshë tek njerëzit
- Nuk i sjell duart në gojë
- Nuk mund të mbajë kokën lart kur jam shtrirë në bark

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua çdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Sidomos më pëlqen kur ata:**

- Më përkëdhelin, flasin dhe luajnë me mua gjatë ushqyerjes, veshëmbathjes dhe larjes. Ata më shikojnë në sy gjatë këtyre veprimeve. Poashtu, ata luajnë në dysheme me mua çdo ditë.
- Kanë krijuar një orar ditor për mua, p.sh. unë flej më shumë gjatë natës se sa gjatë ditë, dhe në përgjithësi kam orare të rregullta.
- Kanë mësuar të lexojnë gjendjen time. Nëse unë jam i/e lumtur, ata vazhdojnë të njëjtin aktivitet me mua. Nëse unë jam mërzitur, ata me kushtojnë kohë dhe më ngushëllojnë mua.
- Përgjigjen kur unë nxjerr zëra apo gugas, herë duke kopjuar zërat e mi e herë duke përdorur fjalë të qarta. Kur unë buzëqesh, buzëqeshin edhe ata.
- Flasin me rradhë [kur unë gugas apo lëshoj zëra, ata dëgjojnë dhe buzëqeshin, kur unë ndaloj, ata flasin]. Ata përsërisin tingujt e mi dhe thonë fjalë të thjeshta me ato tinguj.
- I kushtojnë vëmendje mënyrave të ndryshme se si unë qaj, në mënyrë që të mësojnë dhe të kuptojnë se çfarë unë dëshiroj.
- Lexojnë libra me ngjyra për mua çdo ditë. Ata më lavdërojnë kur unë lëshoj zëra dhe "lexoj". Ata më tregojnë gjëra të reja dhe i emërtojnë ato.
- Emërtojnë gjërat që shikoj unë dhe më flasin për ato.
- Marrin dhe me kthejnë lodrën që më ka rënë nga dora në dysheme. Kjo lojë më ndihmon të mësoj shkakun dhe efektin.
- Më tregojnë fotografi të ndritshme nga ndonjë revistë dhe emërtojnë atë çfarë shoh në fotografi
- Nuk më lënë të shikoj TV ose të luaj me pajisjet e tjera teknologjike. Unë nuk kam nevojë për ato në këtë moshë.
- Më mbajnë mua derisa ulen ose me vendosin jastëkun të mbështetem. Ata më lejojnë të shikoj përreth dhe më japin lodra përderisa unë balancohem.

**Si Fëmijët e Tjerë 4 Muajsh, Unë Kam Filluar Të:**

- Buzëqesh spontanisht, sidomos tek njerëzit
- Pëlqej lojën me njerëz dhe të qaj kur ndalon loja
- Kopjoj lëvizjet dhe shprehjet e fytyrës, si të qeshurën dhe ngrysjen
- Njoh fytyrat e njohura nga distanca dhe të dalloj të huajt
- Luaj me të tjerët, sidomos prindërit
- Dëshiroj të shikoj veten në pasqyrë
- Përcjellë me sy gjërat që lëvizin
- Përgjigjem emocioneve të të tjerëve
- Murmurojë zëra apo fjalë të ndryshme
- Qajë në mënyra të ndryshme për të treguar urinë, dhimbjen ose lodhjen
- Përgjigjem ndaj tingujve duke bërë tinguj
- Përgjigjem kur thërrasin emrin tim
- Bëj tinguj për të treguar gëzim dhe pakënaqësi
- Them tinguj të njëtrajtshëm (me "m", "b")
- Përgjigjem ndaj dashurisë
- Arrijë të marr lodrën me një dorë
- Përdori duart dhe sytë në një drejtim, kur përpiqem të arrijë një lodër
- Sjell gjërat dhe duart në gojë
- Tregoj kuriozitetin tim rreth gjërave dhe përpiqem të marrë gjërat që janë të paarritshme për mua
- Mbjaj kokën të qëndrueshme, të pambështetur
- Shtrihem kur nuk mund të qëndroj në sipërfaqe të vështirë
- Ndonjëherë rrokullisem nga barku në shpinë
- Mund të mbajë një lodër dhe ta lëkund atë apo ta lëzivi drejt lodrave tjera
- Kur shtrihem në stomak, shtyej deri në bërryla
- Rrotullem në të dy drejtimet (para dhe prapa, prapa përpara)
- Ulem pa mbështetje

**Nënë dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Nuk përcjelli gjërat deri sa ato lëvizin
- Nuk u buzëqeshi njerëzve
- Nuk mund ta mbajë kokën qëndrueshëm
- Nuk krijoi tinguj apo zëra
- Nuk l sjell gjërat në gojë
- Nuk shtyej me këmbë kur shputat l kam në sipërfaqe të forte
- Kam pengesë të lëzivi njërin apo dy sytë në të gjitha drejtimet

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua cdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Sidomos më pëlqen kur ata:**

- Krijojnë orar të rregullt për ushqimin dhe fjetjen time
- Më mbajnë dhe bisedojnë me mua duke qeshur
- Imitojnë zërat dhe tingujt që bëj unë
- U kushtojnë vëmendje gjërave që mua më pëlqejnë dhe nuk më pëlqejnë
- Ndajnë kohën të lexojnë ose të këndojnë për mua
- Qeshin dhe gëzohen kur unë lëshoj zëra dhe tinguj
- Më japin mua lodra me ngjyra të përshtatshme për moshën time
- Më lejojnë të eksploroj rrethin tim
- Luajnë fshehtas me mua
- Më mbeshtesin që të qëndroj në këmbë mbi sipërfaqe të forte dhe flasin me mua
- Më ndihmojnë të mbajë lodra e mija

**Si Fëmijët e Tjerë 6 Muajsh, Unë Kam Filluar Të:**

- Njoh fytyrat familjare dhe të dalloj nëse dikush është i huaj
- Dëshiroj të luaj me të tjerët, sidomos me prindërit e mi
- Përgjigjem ndaj emocioneve të njerëzve të tjerë dhe shpesh dukem i/e lumtur
- Kopjoj disa lëvizje dhe shprehje (mimika) të fytyrës, si e qeshura apo mërrolat
- Përgjigjem ndaj tingujve apo zërave duke bërë tinguj. Bëj tinguj me shprehje dhe kopjoj tingujt që i dëgjoj.
- Lidhë zanoret së bashku kur gugas ("ah", "eh", "oh") dhe më pëlqen të luaj me prindërit ndërsa bëj tinguj
- Përgjigjem/reagoj kur më thërrasin me emër dhe kthej kokën në drejtim të zërit
- Bëj zëra për të treguar gëzim dhe pakënaqësi
- Ndryshoj të qarët sipas nevojës [uri, dhimbje, lodhje]
- Përdori duart dhe sytë në një drejtim, kur përpiqem të arrijë një lodër. Tregoj kureshtje (kuriozitet) rreth gjërave dhe përpiqem të marrë gjësende, lodra që janë të paarritshme
- Të dallojë ngjyrat
- Sjelli duart dhe gjërat apo lodrat e ndryshme në gojë
- Mbaj kokën qëndrueshëm, të pambështetur
- Rrotullohem në të dy drejtimet (para dhe prapa, prapa dhe përpara)
- Ulem pa mbështetje
- Mbështetem në këmbë dhe nganjëherë mund të lakoj gjujtë për t'u luhatur

**Nënë dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Nuk përpiqem të marrë gjërat që i kam përreth apo nuk jam i/e interesuar
- Nuk u përgjigjem tingujve apo zërave
- Nuk ju buzëqesh njerëzve
- Kam vështirësi me i sjell gjërat në gojë
- Nuk bëj tingujt e zanoreve ("ah", "eh", "oh")
- Nuk rrokullisem në asnjë drejtim
- Dukem shumë i/e ngurtë, me muskuj të shtrënguar

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua çdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Sidomos më pëlqen kur ata:**

- Më ushqejnë vetëm më qumësht të gjirit deri në gjashtë (6) muaj.
- Më përkëdhelin, flasin dhe luajnë me mua gjatë veshëmbathjes dhe larjes. Ata më shikojnë në sy gjatë këtyre veprimeve dhe luajnë me mua në dyshme çdo ditë.
- Mësojnë të lexojnë gjendjen time.
- Përgjigjen kur unë nxjerr zëra apo gugas, herë duke kopjuar zërat e mija, herë duke përdorur fjali të qarta. Kur unë buzëqesh, buzëqesh edhe nëna dhe babai.
- Flasin me radhë [kur unë gugas apo lëshoj zëra, ata më dëgjojnë dhe buzëqeshin; kur unë ndaloj, ata flasin]. Ata poashtu përsërisin tingujt e mi dhe thonë fjali të thjeshta me ato tinguj.
- Lexojnë libra me ngjyra për mua çdo ditë. Ata më lavdërojnë kur unë lëshoj zëra dhe "lexoj" gjithashtu. Ata më tregojnë gjëra të reja dhe i emërtojnë ato.
- Kur unë shikoj diçka, ata më tregojnë atë dhe flasin për atë që po e shikoj.

- Kur unë lëshoj një lodër në dysheme, e marrin dhe më kthejnë lodrën. Kjo lojë më mëson mua shkakun dhe pasojën.
- Më shmangin TV ose pajset e tjera teknologjike. Unë jam i/e vogël dhe nuk kam nevojë për ato në këtë moshë.
- Më mbajnë mua derisa të ulem ose më mbështesin në jastëk. Kjo më lejon të shikoj

përreth dhe më japin lodra deri sa të balancohem.

- Nuk më shkundin dhe nuk më bërtasin në asnjë rast.
- Sigurohen që unë të flejë vetëm në shpinë.
- Më vaksinojnë me kohë dhe sipas kalendarit të vaksinimit.

**Si Fëmijët e Tjerë 9 Muajsh, Unë Kam Filluar Të:**

- Kem frikë nga fytyra jo familjare/ të huajt
- Preferoj një lloj të caktuar të lodrave (kam lodra të preferuara)
- Kuptoj kur më thonë "jo"
- Bëj tinguj të ndryshëm si "mamamama" dhe "Bababababa"
- Kopjoj tingujt dhe gjestet e të tjerëve
- Përdori gishtat për të treguar gjëra
- Përcjelli me sy kur dicka bie
- Kërkoj gjërat që nëna dhe babai i fshehin
- Vendosi gjëra të ndryshme në gojë
- Lëvizi gjërat pa ndonjë problem nga njëra anë në tjetrën
- Qëndroj në këmbë duke u mbajtur
- Ulem pa mbështetje

**Nëna dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Nuk mund të rri në këmbë me mbështetje
- Nuk mund të qëndroj ulur pa ndihmë
- Nuk thërras ("nana", "baba", "dada")
- Nuk luaj ndonjë lojë që përfshin kthimin përpara dhe mbrapa
- Nuk reagoj kur më thërrasin në emrin e vet
- Nuk i njoh fytyrat familjare
- Nuk shikoj kur provojnë të më tregojnë një objekt
- Nuk i lëvizi lodrat nga njëra anë në tjetrën

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua çdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Sidomos më pëlqen kur ata:**

- I kushtojnë vëmendje mënyrës se si unë reagoj ndaj situatave të reja dhe ndaj njerëzve; ata përpiqen dhe vazhdojnë të bëjnë gjërat që më bëjnë të lumtur dhe të rehatshëm.
- Më qëndrojnë shumë afër kur unë lëvizi më shumë në mënyrë që unë ta di se ata janë afër.
- Luajnë lojëra të tilla si "tani është radha ime, radha jote."
- Thonë se çfarë mendojnë për mënyrën se si unë ndjehem. Për shembull "Po dukesh i/e trishtuar, le të shohim nëse mund t'ju bëjmë të ndjehesh më mirë".
- Përshkruajnë çfarë kërkoj unë; për shembull, "Top i kuq, i rrumbullakët".
- Flasin për atë që unë dëshiroj kur unë shikoj diçka që mund të më pëlqej.
- Kopjojnë tingujt dhe fjalët e mia.
- Kërkojnë sjelljet që dëshirojnë nga unë. Për shembull, në vend që të thonë "mos qëndro", më thonë "koha për t'u ulur".
- Më mësojnë mua shkakun dhe efektin p.sh. duke shtyrë një makinë lodër (kthimi mbrapa) dhe duke e gjuajtur topin
- Lexojnë dhe flasin me mua
- Më japin mua hapësirën për të lëvizur që të eksploroj në një mjedis të sigurtë.

**Si Fëmijët e Tjerë 1 Vjec, Unë Kam Filluar Të:**

- Turpërohem nga fytyrat e panjoura/të huajt
- Qaj kur nëna ose babai largohen
- Kem gjësende dhe njerëz të preferuar
- Shfaq frikë në situata të caktuara
- Zgjas librin kur dua të dëgjoj një tregim
- Përsëris zërat ose veprimet për të tërhequr vëmendjen
- Zgjas dorën ose këmbën për të ndihmuar të vishem
- Përgjigjem ndaj kërkesave të thjeshta që m'1 thonë
- Lëviz kokën për të thënë "po" ose dorën për të përshëndetur
- "tung-tung"
- Krijoj tinguj me ton ndryshues (që ngjason me të folur)
- Përpiqem të kopjoj fjalë që ju thoni
- Gjej gjërat e fshehura
- Shikoj saktësisht gjësendet që përmenden
- Vendosi dhe zhvendosi objektet nga kutitë
- Shenjoj me gishtin tregues
- Zbatoj instruksionet si "kape lodrën"
- Ulem pa ndonjë ndihmesë
- Ngritem në këmbë dhe eci duke u mbajtur për mbështetje
- Mund të qëndroj në këmbë pa mbështetje dhe të bëjë disa hapa

**Nënë dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Nuk zvarritem
- Nuk mund të qëndroj në këmbë me mbështetje
- Nuk 1 kërkoj gjërat që prindërit po 1 fshehin nga unë
- Nuk them dot fjalë si "nana" ose "dada"
- Nuk mësoj gjetet si tundjen e kokës ose valëvitjen e dorës
- Nuk shenjoj me gisht drejt objekteve
- Humbas disa nga aftësitë që kisha

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua cdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Prindërit po aqshu mund të praktikojnë këto veprime:**

- T'1 japin kohë fëmijës që të mësohet ngadalë me një kujdestar të ri. Ata mind t'1 ofrojnë batanije ose lodër që fëmijët të ndjehen rehat
- Të thonë "Jo" të prerë. Të mos bërtasin ose të mos japin shpjegime të gjata pasi që fëmija do të kuptoj përgjigjen brenda 30 sekonda deri në 1 minutë.
- T'1 ofrojnë fëmijëve shumë përqaftime, puthje dhe lëvdata për sjellje të mire.
- Të shpenzojnë kohë për të inkurajuar sjellje të mira dhe jo duke dënuar sjellje të këqija (4 herë më shumë kohë për të inkurajuar sjellje të mira).
- Të flasin për atë se çfarë po bëjnë. Për shembull "Nëna po pastron duart e tua me një peshqir".
- 1 lexoni fëmijës tuaj cdo dite. Lëreni fëmijën të kthejë faqen dhe 1 emërtoni me radhë ilustrimet.
- 1 ndihmoni të përfundojë fjalën kur ai/ajo emërton një objekt. Për shembull, nëse fëmija shenjon një kamion dhe thotë "k" ose "kamion", ju 1 thoni "po, ai është një kamion 1 madh 1 kaltër".
- 1 jepni ngjyra dhe e lejoni të bëjë vija sipas dëshirës në fleta, duke e udhëzuar. E lavdëroni kur ju kopjon.
- Luani me të me kocka, forma të ndryshme, ose lodra që e inkurajojnë të përdorë duart.
- Fshihni lodrat dhe 1 kërkoni që fëmija t'1 gjejë ato.

- Kërkoni nga fëmija që të emërtoj pjesët e trupit ose gjëra që sheh.
- I këndoni dhe e inkurajoni të lëvizë me ju.
- I krijoni një hapësirë të përshtatshme për të hulumtuar lirshëm. I ofroni një lidër që mund ta shtyejë, sic është një vagon ose makinë.



**Si Fëmijët e Tjerë 18 muajsh, Unë Kam Filluar të:**

- I'a zgjas të tjerëve gjërat e lojës
- Kam disponim të ndryshueshëm
- Frikësohem nga njerëzit që nuk I njoh
- Jam i/e afërt me njerëzit që I njoh
- Luaj me role, si për shembull ushqej kukullën time
- Bëj me shenjë drejt gjërave që më duken interesante
- Eksploroj vetëm por jo larg prindërve të mi
- I them shumë fjalë ndaras
- Them "jo" dhe e tregoj edhe me lëvizje të kokës
- E di se qka janë shume gjëra si telefoni, luga, furqa e dhëmbëve
- Tërheqi vëmendjen e të tjerëve duke shenjuar me gisht
- Mund t'i kuptoj instruksionet 1-fjalëshe, pa ndonjë përshkrim.
- Për shembull, unë ulem kur më thonë "ulu".
- Eci vetëm
- Mund të shpejtojë hapin dhe të vrapoj
- Ngreh lodrat e mia duke ecur
- Mund të ndihmoj të zhvishem
- Pijë ujin nga gota
- Ushqehem me lugë

**Nënë dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Nuk tregoj me gisht drejt gjërave
- Nuk mund të eci
- Nuk e kuptoj se për çfarë përdoren objektet që I kam përreth gjithmonë
- Nuk mësoj fjalë të reja
- Nuk I them së paku 6 fjalë
- Nuk e vërej ose shikoj kur prindi im ose kujdestari vijnë ose largohen
- Humbas aftësitë që I kisha

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua çdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Prindërit po aшту mund të praktikojnë këto veprime:**

- Të ofrojnë një ambient të sigurtë, me rutina të parashikueshme për fëmijët.
- Të lavdërojnë më shumë sjellje të mira dhe të mos shpenzojnë shumë kohë duke dënuar sjellje jo të mira.
- Të përshkruajnë emocionet e fëmijës. Për shembull "Ti je e lumtur kur e lexojmë librin".
- Të luajnë me role.
- Të inkurajojnë bashkëndjesinë. P.sh., të inkurajojnë fëmijën e tyre të përqafin një fëmijë që po qan.
- Të lexojnë libra dhe të flasin për ilustrimet me fjalë të thjeshta.
- Të kopjonë fjalët e fëmijës së tyre.
- Të përdorin fjalë dhe fjali të thjeshta, dhe t'i bëjnë pyetje fëmijës.
- Të fshehin objektet që fëmija t'i gjej ato. Të luajnë me kocka, pazël dhe lojëra që mësojnë zgjidhjen e problemeve.
- Të krijojnë hapësira të sigurta për lojën dhe ecjen e fëmijëve.
- Të ofrojnë lodra që fëmijët mund të tërheqin dhe shtyejnë me lehtësi, dhe topa që mund të gjuajnë.
- Të inkurajojnë fëmijën të përdorë gotën dhe lugën, pa marrë parasysh sa i/e cregulltë është.
- Të bëjnë balona me ujë dhe shukumë dhe të inkurajojnë fëmijën t'i prekë ato.

**Si Fëmijët e Tjerë 2 vjec, Unë Kam Filluar të:**

- Kopjoj të tjerët, sidomos të rriturit dhe fëmijët më të mëdhenjë
- Kënaqem kur jam me fëmijë të tjerë
- Pavarësohem ngadalë
- Vepro ndonjëherë kundrejtë instruksioneve që më japin
- Shenjoj drejt gjërave kur dëgjoj emrin e tyre
- Them emrat e personave që njoh dhe të pjesëve të trupit
- Them fjali me 2 deri 4 fjalë
- Mund t'i kuptoj dhe aplikoj instruksionet që më japin
- Përsërisë fjalët që dëgjoj në një bisedë
- Gjej gjësendet e fshehura edhe nën dy ose tre shtresa
- Dalloj format dhe ngjyrat
- Përfundoj fjalitë dhe rimat në librat që I njoh
- Ndërtoj kulla të larta deri në 4 kocka dhe mund ta përdori një dorë më shumë se tjetrën
- Përcjelli instruksionet e thjeshta me dy hapa, si p.sh. "Merri këpuçët e tua dhe vendosi në raft."
- Mund të them emrat e figurave në libër si macja, qeni, zogu.
- Qëndroj në majë të gishtave të këmbës
- Godas topin me këmbë
- Mund të vrapoj, të ngjitem dhe të zbres nga orenditë në shtëpi
- Mund të eci poshtë dhe lartë shkallëve duke u mbajtur në anësore
- Mund të kopjoj ose vizatoj vet vija të drejta dhe rrrathë

**Nënë dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Nuk mund të them fraza 2-fjalëshe (p.sh. qumësht)
- Nuk di se çfarë të bëj me lugën, furqën e dhëmbëve, telefonin, etj.
- Nuk kopjoj veprimet ose fjalët
- Nuk I përcjelli instruksionet e dhëna
- Nuk mund të eci në mënyrë stabile
- Humbas aftësitë që kisha

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua çdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Prindërit po aq mund të praktikojnë këto veprime:**

- Inkurajoni fëmijën të ndihmoj në punë si përgatitja e darkës, pastrimi, etj. Lavdëroni fëmijën që është ndihmës shumë i/e mirë.
- Në këtë moshë fëmijët luajnë pranë njëri-tjetrit por jo mire me njëri-tjetrin. Kur janë me fëmijë të tjerë, vendosni sa më shumë lodra dhe ndërhyri nëse ata fillojnë të grinden.
- Shpenzoni më shumë kohë duke e lavdëruar fëmijën tuaj se sa duke e kritikuar dhe dënuar.
- U'a mësoni emrat e kafshëve, pjesëve të trupit dhe objektet e tjera. Mos I kritikoni kur ata I thonë gabim fjalët, por I përsërisni edhe njëherë, si p.sh. "Ky është një top."
- Inkurajoni fëmijët të thonë fjalët dhe jo të shenjojnë gjësendet, e t'i ndihmoni edhe me shkronjën e pare.
- Fshihni gjëra në vende të ndryshme dhe inkurajoni që fëmija t'i gjejë. Inkurajoni të luaj me kocka, pazel, dhe të vizatojë. Më pas varni punimin e tyre në një hapësirë të dukshme në shtëpi.
- Kërkoni nga ata të ju ndihmojnë duke hapur derën, duke kthyer faqen e librit etj. Kur fillojnë të ecin, I kërkoni të bartin gjëra të vogla për ju.
- Luani me fëmijët në park duke I inkurajuar të jenë sa më aktiv me ngjitje në pasisje, ecje dhe vrapim.

**Si Fëmijët e Tjerë 3 vjec, Unë Kam Filluar të:**

- Kopjoj të rriturit dhe shokët e shoqet
- Tregojë afërsi ndaj shokëve/shoqeve, dhe kujdesem nëse qajnë
- Të luaj sipas rradhës me shokët/shoqet
- Kuptoj se çfarë më përket mua dhe çfarë jo
- Shpalosi shumë emocione të ndryshme
- Mund të qëndroj i/e ndarë nga nëna dhe babai
- Vishem dhe zhvishem vet dhe më pengon ndryshimi i rutinës
- Aplikoj instruksionet me 2 ose 3 hapa/faza
- Kuptoj fjalët si “në”, “mbi”, “nën” dhe mund të emërtoj shumë objekte/gjësende
- Mund të them emrin, mbiemrin, gjininë
- Mbaj në mend emrin e shokut/shoqes, dhe mund të them për emrat si “unë”, “ti”, “ne”, etj.
- Flas në mënyrë të kuptueshme edhe për personat më të rritur, dhe mund të bisedoj duke thënë 2-3 fjali.
- Mund të përdori lodra me shumë komanda/butons të ndryshme, dhe mund të luaj me pazel
- Kuptoj çfare do të thotë “2” dhe mund të kopjoj/vizatoj një rreth
- Mund të kthej faqet e librit një nga një dhe të ndërtoj kulla me 6 kate ose kocka
- Mund të hapi kapak të ndryshëm dhe dorezën e derës
- Vrapoj me lehtësi dhe ngjitem mirë.
- Ngjitem shkallëve pa problem, madje ngas biciklele me tre rrota.

**Nënë dhe baba, veproni herët duke biseduar me mjekun familjar apo infermieren nëse unë:**

- Rrëzohem shpesh ose nuk mund të ngjithem shkallëve
- Flas në mënyrë të paqartë
- Nuk mund të realizoj lojëra të thjeshta (pazël, lëvizja e dorezës së derës)
- Nuk flas duke krijuar fjali
- Nuk i kuptoj instruksionet e thjeshta
- Nuk luaj me role
- Nuk dëshiroj të luaj me fëmijë të tjerë dhe lodra
- Nuk bëj kontakt sy-më-sy
- Humbas aftësi që i kisha

**Mua më pëlqen shumë kur nëna dhe babai im luajnë me mua cdo ditë. Kjo më ndihmon të mësoj dhe të rritem. Prindërit po aqhtu mund të praktikojnë këto veprime:**

- Të dërgojnë fëmijët në park ose hapësira ku mund të shoqërohen dhe luajne me fëmijët e tjerë.
- Të bashkëpunojnë me fëmijët nëse ata janë të pikëlluar.
- Të flasin për emocionet e fëmijëve si “mund ta shoh që je nevrkosur pasi e hodhe kockën e pazel”.
- Të definojnë rregulla dhe limite për fëmijët e tyre. Nëse ai/ajo thyen rrgullin, t’i ulin në një karrige ose në dhomën e tyre për 30 sekonda deri në 1 minutë. T’i lavdërojnë fëmijët kur respektojnë rregullat.
- T’i lexojnë fëmijëve cdo ditë dhe të kërkojnë nga fëmijët t’i përsërisin fjalët dhe të shenjojnë ilustrimet.
- Të krijojnë pakon e fëmijës me ngjyra druri ose qiri, fleta vizatimi dhe t’i inkurajojnë të vizatojnë.
- Të luajnë lojën e kombinimit, si gjetja e dy gjërave të njejta në shtëpi.
- Të luajnë lojën e numërimit, si numërimi i shkallëve, pjesëve të trupit ose gjërat përreth.
- T’i kapin dorën gjatë ngjitjes së shkallëve, dhe nëse janë stabil, t’i inkurajojnë të përdorin anësoret.
- Të luajnë në park ose ambient të hapur me fëmijët ku ata mund të luajnë lirshëm.